



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 187/2 .Prot

Gramsh më 07.02.2022

VENDIM

Nr 6 Date 28 . 01 .2022

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË KULLOTAVE E LIVADHEVE TË GATËSHME PËR
KULLOTJE E KOSITJE SI DHE TË KONTRATËS TIP.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28/01/2022 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, neni 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1;2;3;4;5 dhe 6, neni 17(përdorimi i sipërfaqes së tokës), në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualidht ne administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016” Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave ë të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, kreu i II-të, pika 1,2 dhe 12, si dhe të ligjit nr .139 datë 17.12.2015”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 3 gërma “ç”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma “k” e tj:

VENDOSI

1. Të miratojë listën e kullotave dhe livadheve të gatshme për kullotje e kositje, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë kontratën tip për dhënien me qera të kullotave e livadheve, bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ,Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë,Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes..

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dësja nr:
Afati i ruajtjes: RHK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

Adresa: Sheshi “Kamber Dermyshe” Bulevardi “10 Korriku”, E-mail:bashkia.gramsh2017@gmail.com